

Syllabus i lëndës

Lënda: **FILOZOFI - HYRJE NË FILOZOFI TË PËRGJITHSHME DHE ATË ISLAME**

Programi i studimit: **Teologji**

Numri i ECTS kredive: **5 ECTS Kredi**

Niveli dhe lloji i lëndës: **Obligative**

Kodi i lëndës: **209**

Viti i studimit: **2026/2027**

Fondi i orëve: **2+1 (semestri IV)**

Profesori: **Dr. Abdulkader Durguti**. Kontakti: e-maili: **abdulkaderdurguti@gmail.com**

Qëllimi i lëndës

Pajisja e studentëve me njohuri bazë nga lëmi i Filozofisë, në përgjithësi dhe asaj islame në veçanti. Studenti do t'i hulumtojë dhe studiojë bazat e filozofisë, botëkuptimet e saj te popujt e ndryshëm, si dhe në periudha të ndryshme të historisë së saj, raporti i saj me shkencat tjera, si dhe temat më kryesore të filozofisë. Zhvillimi i shkathtësive dhe aftësive për të analizuar të dhënat e koncepteve të ndryshme filozofike të cilat përfshin programi studimor në mënyrë, që të mund të nxjerrin konkluzione për to. Fitimi dhe avancimi i sensit kritik në aspektin e vlerësimit të argumenteve bazuar në fakte përkatëse filozofike. Aftësimi për të shkruar ese apo për të diskutuar për tema të ndryshme filozofike, në një stil të pastër dhe bindës në të shprehurit me gojë dhe me shkrim, tipare këto të një personi me një edukim liberal akademik. Prej leksioneve nga Filozofia presim që studentit pas përfundimit të këtij kursi do të përfitojë kulturë të përgjithshme për tematikat filozofike më kryesore gjatë historisë dhe në të tashmen, me theks të veçantë për tematikat e filozofisë islame të frymëzuara nga filozofia kuranore. Të kuptojë proceset e zhvillimit filozofik që nga paraqitja e saj e deri në ditët e sotme. T'i jepet mundësi studentit që në formë kritike duke nxitë debate, të bëjë krahasimin e rrymave të ndryshme filozofike, për të zgjedhë atë më të përshtatshëm për vendin tonë. Të kuptojë se zhvillimi i filozofisë është një çështje e pandalshme dhe kërkon kontribut të secilit brez për të arritur në njohuri sa më të shëndosha, dhe në këtë mënyrë të avancohet sa më tepër jeta shoqërore.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të kursit, studentit do të jetë në gjendje të:

Të përshkruaj etapat e zhvillimit të filozofisë gjatë historisë antike si dhe asaj moderne.

Të krahasoj ndërmjet rrymave të ndryshme filozofike të cilat i studion gjatë kursit.

Të diskutoj rreth tematikave filozofike në bazë të argumenteve të tyre, duke arritur në konkluzione sa më të qarta dhe të jetë sa më objektiv.

Të mbroj qëndrimet e rrymave të ndryshme filozofike, ashtu siç i konceptuan themeluesit e tyre.

Të parashtrij mendimin kritik ndaj secilës prej tyre, duke përfunduar në atë me argumente më të shëndosha.

Të jetë në gjendje që njohuritë e fituara t'i aplikoj në relacionin ndërshoqërorë.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave, me anë projektorit, i cili i ndihmon studentët që ta kuptojnë edhe më qartë ligjëratën, stimulimit të tyre në diskutime interaktive, duke bërë pyetje dhe analiza në kuadër të ligjëratës së mbajtur. Po ashtu do të mbahen seminare dhe ese të ndryshme, të cilat do të prezantohen në mënyrë individuale por edhe grupore, dhe teste të vetëvlerësimit. Gjithashtu studentët kanë mundësi që gjatë përgatitjes së lëndës të kontaktojnë me profesorin dhe të marrin udhëzime me qëllim të arritjes së cilësisë dhe rezultateve sa më të mira.

Përmbajtja e lëndës:

Java e parë: Hyrje në Filozofi. Njohja me syllabusin, metoda, organizimi, kërkesat dhe vlerësimi. Shqyrtime të përgjithshme: Filozofia si dukuri mbarë njerëzore. Motivet e filozofisë.

Literatura: Dr. Zija Abdullahu, "*Hyrje në filozofi*".

Java e dytë: Përkufizimi dhe detyrat e filozofisë. Dobitë e filozofisë.

Propozimi i temave për punime seminarike dhe për ese.

Literatura: (f. 12-21)

Java e tretë: Koncepti historik i filozofisë në: Lindjen e Lashtë, Greqinë e Lashtë, në komunitetin islam, në mesjetë dhe në kohën moderne.

Bisedë interaktive, duke krahasuar këto koncepte njëri me tjetrin.

Literatura: (f. 22-30)

Java e katërt: Relacioni i filozofisë me fushat tjera të njohurisë. Shkenca dhe filozofia. Filozofia dhe religjioni.

Leximi i punimeve seminarike dhe eseve dhe diskutimi rreth tyre.

Literatura: (f. 31-39)

Java e pestë: Tematikat e filozofisë: Epistemologjia (teoria e dijes), ontologjia (teoria ekszistencialiste), dhe teoria e vlerave. Gneseologjia (teoria e njohjes). Mundësia e njohurisë, Natyra e njohurisë. Burimet e njohurive.

Literatura: (f. 40-51)

Java e gjashtë: Teoritë më të njohura filozofike. Filozofia materialiste dhe debati me Fenë.

Literatura: (f. 52-61).

Java e shtatë: Filozofia moderne në perëndim dhe religjioni.

Testi i parë.

Java e tetë: Filozofia dhe Islami. Shfaqja e filozofisë tek muslimanët dhe shkaqet. Filozofi arabe apo islame?

Literatura: : Ahmed Fuad el-Ahavani, *Filozofia islame*, përktheu: Ismail Bardhi, Shkup, 2002; f. 13- 17

Java e nëntë: Relacioni i filozofisë islame me filozofinë greke. Raporti i filozofisë islame me shkencat tjera islame; me kelamin, tesavufin, fikhun.

Java e dhjetë: Filozofia islame në Arabinë Lindore. Përfaqësuesit më eminent të filozofisë islame në Arabinë Lindore. Ebu Jakub el-Kindi

Literatura: (f. 74-80).

Java e njëmbëdhjetë: El-Farabi, Ibën Sina,

Literatura: (f. 81-85).

Java e dymbëdhjetë: Filozofia islame në Arabinë Perëndimore. Jeta intelektuale në magribin islam.

Literatura: (f. 86-94).

Java e e trembëdhjetë: Përfaqësuesit më eminent të filozofisë islame në Arabinë Pwrendimore. Ibn Rushdi, Ibën Baxhe, Ibën Tufejli.

Literatura: (f. 95-102)

Java e e katërbëdhjetë: Ilmul Kelami dhe filozofia islame.

Leximi i punimeve seminarike dhe eseve dhe diskutime rreth leksioneve nga orët e mëparshme.

Testi përfundimtar.

Kriteret dhe komponentët e vlerësimit:

Prezantimi dhe aktiviteti gjatë orës: **10 pikë**

Punimi seminarik: **10 pikë**

Vlerësimi i testit të parë: **20 pikë**

Vlerësimi i testit të dytë: **20 pikë**

Provimi final: **40 pike**

Standardi i notimit në FSI:

10= 90% - 100%. SHKËLQYESHËM- njohuri të shkëlq. me vetëm disa gabime minore.

9= 80 – 89. SHUMË MIRË – mbi mesatare standarde, por me disa gabime.

8=70 – 79. MIRË – rezultat në përgjithësi i mire me disa gabime që vërehen.

7=60 – 69. KËNAQSHËM – mire,por me mjaft gabime.

6=50 – 59. MJAFTON – rezultatet plotësojnë kriteret minimale.

5=0 – 49. DOBËT – kërkohet shumë punë për të fituar kredi.

Literatura themelore:

1. Dr. Zija Abdullahu, *Hyrje në filozofinë islame*, dispensë për vitin e tretë (përdorim vetëm i brendshëm, Prishtinë, 2011).
2. Ahmed Fuad el-Ahavani, *Filozofia islame*, përktheu: Ismail Bardhi, Shkup, 2002.

Literatura plotësuese:

1. *Kurani*; përkthim dhe komentim, përktheu: H. Sherif Ahmeti. Medinë, 1992.
2. Sulejmani, Dr. Sejfedin, *Filozofia*, Shkup, 1987.
3. Hersh, Zhanë, *Habia filozofike*, përktheu: Artan Fuga, Tiranë, 1993.
4. Gadamer, Hans-George, *Historia e filozofisë*, përktheu: Alda Mukli, Tiranë, 2008.
5. Corbin, Henry, *Historia e filozofisë islame*, përktheu: Nexhat Ibrahimimi, Shkup, 1997.
6. Tuçi, Gjuzepe, *Historia e filozofisë indiane*, përktheu: Vehap Shita, Prishtinë, 1989.
7. Zakzuk, Dr. Mahmud Hamdi, *Temhidun lil felsefe*, Kajro, 1986.
8. Zajdan, Dr. Mahmud, *Nadharijetul ma'rifeti inde mufek-kiril islam*. Bejrut, 1989.
9. Stumpf, Samuel Enoch, *Filozofia, historia dhe problemet*, përktheu: Kastriot Muftiu dhe Paqsor Shehu, Tiranë pa v. botimi.